



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 369 Akti

Nr. 317 Vendimi

Tiranë, më 20.11.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Etleda Çiftja	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 18.11.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Albano Çepele**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 3, dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Albano Çepele, aktualisht me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Albano Çepele, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), z. Lulzim Hamitaj dhe znj. Alma Faskaj. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionerja znj. Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e datës 19.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Albano Çepele.
5. Me vendim nr. 61, datë 5.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u vendos zëvendësimi i komisioneres Alma Faskaj me komisioneren Etleda Çiftja, për arsye objektive. Komisionerja zëvendësuese deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
6. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Albano Çepele, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.
8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.
9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

11. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Albano Çepele. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar dhe mosdeklarim pasurie,*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontaktet të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 raportin² e vlerësimit të figurës me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017.

Në datën 4.6.2020, DSIK-ja ka dërguar me shkresën nr. *** prot., raportin³ e përditësuar në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43, të ligjit nr. 84/2016, një raport⁴ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tri kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 15.10.2020, vendosi: përfundimin e hetimit kryesisht për të tri kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Albano Çepele; si dhe njoftimin e

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2018.

² Deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 15.6.2020.

³ Deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 15.6.2020.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2020.

subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

16. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkojë marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni.

16.1 Në datën 20.10.2020, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike kërkoi shtyrjen e afatit, për arsye shëndetësore, për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit. Bashkëlidhur kërkesës subjekti vuri në dispozicion raport për paaftësi të përkohshme në pune nr. ***, datë 10.10.2020 dhe nr. ***, datë 19.10.2020.

16.2 Komisioni, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit, vendosi ta pranojë atë duke i shtyrë afatin për paraqitjen e provave dhe shpjegimeve deri në datën 1.11.2020

16.3 Subjekti, në datën 2.11.2020, në përgjigje të rezultateve të hetimit, dërgoi nëpërmjet postës elektronike dokumentin vërtetim, datë 29.5.2020, lëshuar nga ASHK-ja Drejtoria Vendore Fier, por nuk paraqiti parashtrime në lidhje me rezultatet e hetimit.

16.4 Megjithëse subjekti u ftua me anë të postës elektronike dhe u rinjoftua me *e-mail* dhe telefonikisht, në datën 6.11.2020, për të paraqitur parashtrime në përgjigje të rezultateve të hetimit, si dhe për të drejtën e tij për njohjen me dosjen, konstatohet se z. Albano Çepele nuk e ka ushtruar këtë të drejtë.

17. Pas kalimit të afatit, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁵.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 9.11.2020.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 18.11.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

20. Subjekti i rivlerësimit, z. Albano Çepele, së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Z. Albano Çepele nuk ka qenë krejtësisht bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Subjekti është përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, por nuk ka qenë i plotë në shpjegimet dhe provat e paraqitura, duke e vendosur Komisionin në vështirësi për nxjerrjen e rezultateve të hetimit.

⁵ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 9.11.2020.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23. Referuar vendimit nr. 2/2017⁶, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, *Vetting*” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGj-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ; dhe (g) shpjegimet e subjektit dhe përfaqësuesit ligjor të tij gjatë seancës dëgjimore.

VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

⁶ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

26. Apartament banimi⁷ me sip. 86.8 m², Rr. “****” pallati “****”, Njësia Bashkiake nr. **, Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes nr. **, datë 5.4.2006. Vlera: 30.000 Euro. Pjesa *Takuese*: 100 %.

Burimi sipas deklaratës Vetting: Nuk ka deklaruar.

Konstatimi i ILDKPKI-së

- *Subjekti nuk ka deklaruar burimin e shumës prej 30.000 euro që ka shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 86.8 m², Rr. “****”, Tiranë, në vitin 2006, në deklaratën e pasurisë Vetting.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të shumës 30.000 euro, në vitin 2006 nga motra e subjektit.*
- *Subjekti nuk ka deklaruar apartamentin me sip. 63.6 m² në Fier, të përfitur nga privatizimi, në deklaratën e pasurisë Vetting dhe në deklaratat e interesave private ndër vite.*

Hetimi⁸ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

26.1 Me kontratë shitblerje nr. **, datë 5.4.2006, subjekti ka blerë apartament me sip. 86.8 m², Rr. “****”, me vlerë 30.000 euro, e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nga subjekti nuk rezulton të jetë deklaruar burimi për blerjen e këtij apartamenti.

ASHK-ja Tiranë informon se ky apartament ka nr. pasurie **, z. k. **.

26.1.1 Referuar çmimit 30.000 euro, Komisioni ka vlerësuar të pyesë subjektin në lidhje me vlerën e ulët të çmimit të blerjes së këtij apartamenti.

Në përgjigjen e tij⁹, subjekti ka sqaruar se apartamenti është blerë me çmim të ulët, pasi është marrë i papërfunduar dhe është përfunduar gjatë viteve. Ky deklaram i subjektit nuk përputhet me hetimin e kryer nga ku rezulton se ky apartament ka qenë i regjistruar në emër të firmës së ndërtimit që në datën 20.1.2006, ndërkohë në emër të shitësit të apartamentit në shkurt të vitit 2006. Në kontratën e shitblerjes nuk përcaktohet që ky apartament të jetë i papërfunduar.

26.1.2 Në lidhje me këtë konstatim subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar se ka hyrë në pallat përpara përfundimit të tij dhe nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Subjekti sqaron se e papërfunduar ka qenë:

- a. në pjesën e brendshme - pajisjet hidrosanitare të pavendosura;
- b. në pjesën e jashtme - pallati ishte ende i pasuvatuar dhe i palyer, pa ashensor të vendosur dhe kjo gjendje ka vazhduar për disa muaj. Familja e tij ishte familja e dytë banuese në pallat dhe kjo situatë ka zgjatuar disa muaj. Më pas filluan të banonin edhe familje të tjera.

Ndërkohë, në lidhje me shpenzimet e kryera prej tij, subjekti sqaron se nuk ka kryer shpenzime, pasi pajisjet hidrosanitare kanë qenë detyrim i firmës dhe se ka kryer vetëm lyerjen dhe rregullime të vogla.

⁷ Subjekti ka dorëzuar: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 28.4.2006; (ii) kontratë shitblerje nr. **, datë 5.4.2006.

⁸ Shkresë nr. ** prot., datë 12.5.2020; shkresë kthim-përgjigje nr. ** prot., datë 20.5.2020, nga ASHK të Drejtorisë Vendore Tirana Jug; shkresë nr. ** prot., datë 12.5.2020; kthim-përgjigje ASHK-ja Drejtoria Vendore Fier nr. ** prot., datë 21.5.2020.

⁹ Shihni pyetësor nr. 1.

26.1.3 Deklarimet e subjektit rezultojnë kontradiktore pasi fillimisht deklarën se ka hyrë në pallat me punime të papërfunduar dhe ato janë përfunduar gjatë viteve¹⁰, më pas deklarën se nuk ka kryer shpenzime të tjera, por vetëm lyerje dhe rregullime të vogla (asnjë investim i konsiderueshëm)¹¹, duke mos justifikuar në këtë mënyrë vlerën e ulët të çmimit të blerjes së apartamentit.

26.1.4 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimi që të provojë me dokumentacion provues pagesën e shumës 30.000 euro të shitësi i apartamentit. Nga subjekti nuk është depozituar dokumentacion provues.

26.1.5 Subjekti është pyetur në lidhje me mobilimin e apartamentit, por nuk ka dhënë shpjegime për këtë.

26.2 Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, konstatohet se në DVP/2005 subjekti deklarën se ka marrë hua shumën 30.000 euro nga motra e tij, znj. E. Gj. me kontratë huamarrje nr. ***, datë 4.7.2005, të cilën deklarën se do ta përdorë për blerjen e një shtëpie. Ky deklaram i subjektit konfirmohet dhe nga hetimi administrativ¹². Ndërkohë që në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burim për këtë pasuri.

26.2.1 Nga Komisioni është kryer një hetim¹³ i thelluar në lidhje me aftësinë financiare të znj. E. Gj. për dhënien hua të shumës prej 30.000 euro. Në këtë hetim është përfshirë edhe bashkëshorti¹⁴ i saj. Nga përgjigjja e DRT-së Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 24.6.2020, e cila ka vënë në dispozicion të dhëna vetëm për aktivitetin si person fizik të z. Gj. me NIPT *** konstatohet se z. Gj. ka realizuar të ardhura, por këto nuk mund të shërbejnë si burim për huan, pasi janë krijuar shumë kohë pas dhënies së saj. Nga hetimi rezulton se motra e subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në shumën 30.000 euro. Në këto kushte, nëpërmjet dy pyetësorëve, i është kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion provues për të provuar burimin e ligjshëm të ardhurave të motrës së tij, për dhënien e huas në vlerën 30.000 euro. Nga subjekti nuk është depozituar dokumentacion përveç një kontrate dhurimi¹⁵ nr. ***, datë 5.7.2001, nëpërmjet së cilës z. A. Gj. (bashkëshorti i motrës së subjektit) i dhuron shoqërisë “****” sh.p.k. një automjet tip furgon.

26.2.2 Subjekti e ka deklaruar shlyerjen e kësaj huaje, si vijon:

- në DVP/2006, subjekti deklarën se ka shlyer shumën 10.000 euro;
- në DVP/2007, subjekti deklarën se ka shlyer shumën 4.000 euro;
- në DVP/2008, subjekti deklarën se ka shlyer shumën 5.000 euro;

¹⁰ Shihni pyetësin nr. 1.

¹¹ Shihni pyetësorin nr. 2.

¹² Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 21.2.2020, të ILDKPKI-së.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 16.6.2020, nga “Credins Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2020, nga BKT; shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2020, nga ABI Bank; shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2020, nga “Porsche Leasing”, sh.p.k; shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2020, nga “Alpha Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2020, nga “Tirana Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2020, nga “Tirana Factoring&Lease”; shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2020, nga “Albania Leasing”; shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2020, nga “Union Bank”; shkresë nr. ON-A-***, datë 21.2.2020, nga “Fibank”; shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2020, nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë; shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2020, nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. OP-*** prot., datë 28.2.2020, nga “Procredit Bank” – nëpërmjet të cilave informohemi se znj. E. Gj. dhe z. A. Gj. nuk kanë pasur llogari bankare deri në vitin 2006.

¹⁴ Sipas përgjigjes nr. *** prot., datë 6.3.2020, të QKB nëpërmjet së cilës informohemi se:

z. A. B. Gj. figuron i regjistruar si: (i) person fizik me vendim gjykate nr. *** datë 29.6.1993, me aktivitet tregti mallrash shqimore dhe industriale për të cilin nuk gjendet NIPT; (ii) person fizik me vendim nr. *** datë 27.2.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të cilin nuk gjendet NIPT; (iii) person fizik me NIPT ***, data e regjistrimit 12.6.2014, status çregjistruar; (iv) person fizik me NIPT *** i regjistruar 1.1.2005 me aktivitet “Bilardo” dhe i çregjistruar më 14.7.2005.

¹⁵ Shihni pyetësor standard.

- në DVP/20009, subjekti deklaroi se ka shlyer shumën 4.500 euro;
- në DVP/2010, subjekti deklaroi se ka shlyer shumën 3.500 euro;
- në DVP/2011, subjekti deklaroi se ka shlyer shumën 3.000 euro.

26.2.3 Analiza financiare për blerjen e apartamentit dhe shlyerja e plotë e huas

	2006	2007	2008	2009	2010	2011
PASURI	2 778 146	52 479	-173 249	-94 220	219 918	205 791
Apartament me sip. 86.8 m ² , Rr. “***”, Tiranë	3 711 090					
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>-932 944</i>	<i>52 479</i>	<i>-173 249</i>	<i>-94 220</i>	<i>219 918</i>	<i>205 791</i>
Likuiditete Gjendje	220 038	272 517	99 268	5 048	224 965	430 756
TË ARDHURA dokumentuar	989 479	1 020 979	1 003 220	1 116 977	1 197 371	1 246 013
Të ardhura nga paga e subjektit	816 337	839 409	810 294	907 529	924 650	933 649
Të ardhura nga pensioni i babait	118 421	124 384	133 219	146 271	152 848	158 999
Nga pensioni suplementar i babait	52 516	53 929	56 063	58 914	60 884	63 392
Të ardhura nga pensioni i nënës					57 261	84 838
Interesa bankare	2 205	3 258	3 643	4 264	1 727	5 136
SHPENZIME	1 565 701	893 500	1 025 773	1 027 125	895 695	868 325
Shpenzime jetese	328 671	409 860	409 860	409 860	409 860	409 860
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>						43 565
Paguar huaja te motra	1 237 030	483 640	615 913	617 265	485 835	414 900
Mundësia për kursime	-3 354 368	75 000	150 696	184 073	81 758	171 898

Në analizën financiare janë përfshirë subjekti dhe prindërit e tij, pasi konsiderohen si persona të lidhur me subjektin, për sa kohë gjenden në certifikatën familjare të tij. Huaja e marrë nga motra E. Gj., nuk është konsideruar si e ardhur në analizën financiare, pasi nuk provohet se ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas.

Nga kjo analizë rezulton se subjekti nuk ka pasur aftësi financiare për blerjen e apartamentit në shumën 3.354.368 lekë, në vitin 2006.

26.2.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektin barrën e provës: (i) ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me arsyet e çmimit të ulët të shitjes së apartamentit; (ii) nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim për blerjen e kësaj pasurie ka shërbyer huaja në shumën 30.000 euro; (iii) nuk ka qenë bashkëpunues me Komisionin, pasi nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me vlerën e mobilimit të këtij apartamenti; (iv) nuk provohet që znj. E. Gj. të ketë pasur aftësi financiare, për të krijuar të ardhura të ligjshme, për dhënien e huas në shumën 30.000 euro; (v) nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e apartamentit.

26.2.5 Pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo të ketë depozituar dokumentacion për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit. Në seancë,

përfaqësuesi i subjektit e ka konsideruar këtë apartament si një investim të motrës së subjektit, por pa dhënë asnjë detaj mbi burimin e të ardhurave të saj. Në lidhje me këtë përfaqësuesi i subjektit u shpreh: *“Për sa i takon objektit të financimit dhe ligjshmërisë së burimit kjo ka rezultuar e provuar me një kontratë huaje, të cilën Komisioni e ka administruar dhe subjekti e ka deklaruar në deklaratën vjetore të pasurive të paluajtshme, në deklaratën e deklarimit të interesave private dhe në deklaratën vetting si pasuri të vetme të subjektit, ku jeton dhe ka realizuar nevojat e strehimit.”*

26.2.6 Pasi dëgjoi shpjegimet e subjektit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, Komisioni vlerëson se të ardhurat e motrës së subjektit nuk justifikojnë huan e dhënë për blerjen e apartamentit. Në këto kushte, konkludohet se subjekti nuk ka pasur mjete të mjaftueshme monetare për blerjen e apartamentit.

Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se subjekti: (i) nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 3,354,368 lekë; (ii) nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e kësaj pasurie dhe, si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

26.3 Gjatë hetimit administrativ, të kryer nga Komisioni, është administruar përgjigjja e ASHK-së Fier, sipas së cilës, subjekti i rivlerësimit së bashku me familjarët e tij ka në pronësi apartament me sip. 63.6 m², në Fier, me nr. pasurie ***, z. k. ***. Origjina e kësaj pasurie është kontratë për privatizim banese, datë 6.10.1993.

26.3.1 Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 1 dhe nr. 2 se është shitur, që në vitin 1995, por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion provues.

26.3.2 Nga hetimi ka rezultuar se:

- i. Ky apartament është ende në pronësi të subjektit dhe familjarëve të tij bazuar në shkresën e ASHK-së Fier.
- ii. Regjistrimi fillestar i apartamentit është bërë nga babai i subjektit në datën 20.11.2000.
- iii. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti

26.3.3 Në përfundim, subjektit iu kalua barra e provës, sipas së cilës subjekti nuk ka deklaruar apartamentin me sip. 63.6 m², në Fier, të përfitur nga privatizimi, në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe në deklaratat e interesave private ndër vite.

26.3.4 Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë konstatim. I vetmi dokument që ka depozituar në përgjigje të rezultateve të hetimit ka qenë një vërtetim i ASHK-së Fier, datë 29.5.2020, sipas së cilit, nga verifikimi i sistemit dixhital të pasurive të paluajtshme, konfirmohet pronësia e z. B. Ç. mbi apartamentin në Fier.

26.3.5 Në seancë, përfaqësuesi i subjektit ka deklaruar se ky apartament në Fier është një pasuri, në të cilën kanë jetuar B. Ç. me Albano Çepelen dhe vajzat përpara vitit 1996. Në vitin 1996, z. B. Ç., babai i subjektit, e ka shitur këtë pasuri nën presionin e dhunës dhe nuk gjendet dokumentacion, nuk ka asnjë të dhënë dhe nuk ka sesi të deklarohet një pasuri, e cila nuk provohet dhe që subjekti nuk e di që ekziston. Sipas përfaqësuesit, dokumentacioni i sjellë nga ASHK-ja Fier relatton vetëm që në sistemin dixhital të pasurive të paluajtshme të Drejtorisë ASHK Fier, shtetasit B. Ç., F. Ç. dhe Albano Çepele kanë në pasuri një apartament me sip. 63

m². Në bazë të ligjit shqiptar çdo pasuri e paluajtshme regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme dhe në këtë rast kemi të bëjmë me një regjistrim në sistemin dixhital të pasurive të paluajtshme, i cili është një sistem ndihmës i administratës shtetërore dhe nuk përbën Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Sistemi dixhital i pasurive të paluajtshme, fletoret e regjistrimit të pasurive të paluajtshme nuk përbëjnë asnjë provë për sa i takon fitimit të pronësisë. Përfaqësuesi i subjektit ka cituar nga përgjigjja e ASHK-së Fier se: “*Drejtoria vendore ASHK Fier nuk disponon regjistrimet e kryera para vitit 1997, pasi dokumentacioni është djegur gjatë trazirave të atij viti.*” Nga i gjithë ky dokumentacion dhe akt pasqyrim rezulton, ka vijuar përfaqësuesi, që nuk kemi asnjë veprim juridik i cili të prodhojë pasoja të fitimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, z. Albano Çepele. Bazuar në nenin 79 të Kodit Civil, vetëm veprimi juridik krijon, ndryshon ose shuan marrëdhëniet juridiko-civile. Në rastin konkret, z. Albano Çepele nuk ka kryer asnjë veprim dhe nuk vërtetohet që të ketë kryer as edhe një veprim, jo për fajin e vet, por për efekt të mënyrës dhe gjendjes së administratës shtetërore pas vitit 1997. Në këtë koncept për sa i takon relatimit për pasurinë e ndodhur në Fier, subjekti i rivlerësimit nuk mund të gjendet fajtor për sa i takon mosdeklarimit apo mosverifikimit apo mossjelljes së dokumentacionit që përbën barrën e provës. Është një send për të cilin as nuk provojmë pronësi, nuk provojmë asnjë veprim juridik të subjektit të rivlerësimit që të pasqyrohet në deklaratën *Vetting*.

26.3.6 Pasi dëgjoi shpjegimet e subjektit, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, Komisioni konkludon se apartamenti me sip. 63 m² është përfituar nga prindërit e subjektit nga privatizimi, ky apartament mund të jetë shitur, siç deklaroi subjekti, që në vitin 1996, por nuk disponohet asnjë kontratë shitblerjeje, ndërkohë që ASHK-ja Fier konfirmon pronësinë e z. Çepele mbi këtë apartament. Në rast se do të kishim administruar një kontratë shitblerjeje, është e qartë që nuk do të mund të ngarkohej me përgjegjësi shitësi, z. Çepele, për mosregjistrim të kësaj kontrate në zyrën përkatëse. Subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar të gjitha pasuritë e tij në deklaratën *Vetting*. Në rastin e këtij apartamenti subjekti duhej që në deklaratën *Vetting* të deklaronte faktin se ka pasur në pronësi një apartament në qytetin e Fierit, të cilin e ka shitur por nuk disponon dokumentacion.

Në përfundim të analizës së fakteve dhe provave, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pasurinë apartament në pronësi të tij dhe prindërve, si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të gërmes “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

26.4 Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nëna e tij ka marrë trajtim mjekësor në Spitalin Gjerman në shumën 9.930 euro, shumë e cila është mbuluar nga motra e tij, znj. E. B.

26.4.1 I është kërkuar subjektit të rivlerësimit dokumentacion provues për të ardhurat e motrës së tij. Nga subjekti është deklaruar se burimi i të ardhurave janë nga shoqëria e transportit “***” sh.p.k., pronari i së cilës është z. K. B., bashkëshorti i motrës së tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar deklaratë noteriale për njohje detyrimi, datë 21.2.2020, të znj. E. B., e cila deklaroi se: “*Ka kryer një pagesë në shumën 9.930 euro te Spitali Gjerman në lidhje me shërbimet mjekësore të nënës së saj, F. Ç.. Këtë pagesë e ka bërë ajo personalisht nga kursimet familjare që kanë ardhur si rezultat i aktivitetit privat që ka bashkëshorti i saj K. B. i regjistruar si person juridik “***” sh.p.k. Ajo është e punësuar në këtë kompani.*”

Subjekti ka depozituar mandatarkëtimin nr. ***, datë 3.2.2014, nëpërmjet së cilit vërtetohet që pagesa është kryer nga znj. E. B..

26.4.2 Subjektit i është kërkuar në mënyrë të përsëritur që të depozitojë dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të ardhurave të motrës së tij, znj. E. B., por prej tij nuk është vënë në dispozicion dokumentacion provues. Nga hetimi i kryer nga Komisionit ka rezultuar se z. K. B.¹⁶ figuron i regjistruar si administrator dhe ortak zotërues i 100% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k. pajisur me NIPT ***. Nga shkresa e DRTT-së¹⁷, për shoqërinë “****” sh.p.k. rezulton se të ardhurat e deklaruara për periudhën 2003 -2019, janë si vijon:

Viti	Qarkullimi	Fitimi para tatimit	Tatimi	Fitimi pas tatimit
2003	6 017 042	2 400 000	600 000	1 800 000
2004	7 275 320	1 865 300	466 325	1 398 975
2005	7 763 250	2 293 986	527 617	1 766 369
2006	20 339 442	2 729 686	545 937	2 183 749
2007	31 991 141	2 283 599	456 720	1 826 879
2008	52 301 953	4 418 051	441 805	3 976 246
2009	73 015 871	6 022 213	602 221	5 419 992
2010	89 151 763	9 263 146	926 315	8 336 831
2011	105 994 774	9 761 474	976 147	8 785 327
2012	109 381 685	8 694 962	869 496	7 825 466
2013	117 192 098	7 863 870	786 387	7 077 483
2014	150 210 913	11 070 862	1 107 086	9 963 776
2015	174 651 975	18 639 141	2 795 871	15 843 270
2016	185 523 631	22 278 564	3 341 785	18 936 779
2017	167 781 056	26 734 552	4 010 183	22 724 369
2018	179 493 589	19 656 977	2 948 547	16 708 430
2019	159 802 345	24 448 368	3 667 255	20 781 113

Nga kjo shkresë rezulton se shoqëria ka shpërndarë dividend¹⁸ për periudhën 2015 - 2018 në shumën 45.000.000 lekë dhe ka paguar tatim mbi dividendin në shumën 5.700.000 lekë.

Periudha kur është shpërndarë dividend është më vonë se pagesa e shpenzime¹⁹ të znj. F. Ç. dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizë financiare.

26.4.3 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për pagesën e shumës 9.930 euro. Për këtë subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

26.4.4 Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit ka deklaruar se: *“Sa i takon investimit 9.300 euro të motrës në favor të nënës dhe të babait, ky është një investim brenda familjes dhe*

¹⁶ Shihni shkresë nr. *** prot., datë 6.3.2020, të QKB-së.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 24.6.2020, nga DRT-ja Tiranë.

¹⁸ Bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 24.6.2020, është dokumenti vendim i asamblesë së ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k. për shpërndarjen e fitimit për vitet 2015 – 2018.

¹⁹ Mandatarkëtim nr. ***, datë 3.2.2014.

ligjshmëria e këtij investimi është një marrëdhënie familjare që nuk i përket subjektit të rivlerësimit që të japë shpjegime për investime, që vëllai kryen për prindin, motra kryen për prindin apo persona të tjerë kryejnë për prindin e tij. Thjesht ka treguar që ky përfitim shëndetësor është përfituar nga prindërit e vet, nuk ka pasur asnjë dokumentacion për ta sjellë përpara trupit gjykues.”

26.4.5 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se pavarësisht se nga një këndvështrim këto shpenzime janë kryer nga motra e subjektit për nënën e tyre, përderisa subjekti është në një certifikatë familjare me prindërit, ka detyrimin ligjor të provojë burimin e të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve. Rezultati negativ në analizën financiare të kryer për motrën e subjektit nuk justifikon kryerjen e këtij shpenzimi. Komisioni konkludon se personi i lidhur, nëna e tij, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të mbuluar shërbimet mjekësore. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë shpenzim, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

27. Në lidhje me likuiditetet

Hetimi²⁰ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

27.1 Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se subjekti ka pasur depozitë në shumën 5.000 USD nga data 11.5.2005 - 8.9.2006. Në DPV/2004 shuma 5.000 USD është deklaruar si gjendje *cash*, e krijuar “nga kursimet e vjetore dhe si pasojë e këmbimit në tregun e lirë të valutës”. Në DPV/2005 subjekti deklaroi se shuma 5.000 USD është depozituar te “Raiffeisen Bank”.

27.2 Nga analiza financiare e vitit 2004, rezulton se subjekti ka pasur mundësi për të kursyer shumën 5.000 USD dhe rrjedhimisht ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite.

27.3 Ndërkohë në DPV/2005 subjekti deklaroi se ka kursyer *cash* shumën prej 5.000 euro.

	2005
PASURI	680 082
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	680 082
Likuiditete Gjendje	1 152 982
TË ARDHURA dokumentuar	983 909
Të ardhura nga paga e subjektit	816 594
Të ardhura nga pensioni i babait	112 083
Të ardhura nga pensioni suplementar i babait	50 347
Të ardhura nga pensioni i nënës	0
Interesa bankare	4 884
Marrë hua nga motra e tij	0
SHPENZIME	508 671
Shpenzime jetese	328 671
Shpenzime qiraje	180 000

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

27.4 Në përfundim të hetimit, rezulton se për vitin 2005, subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 204.845 lekë. Për këtë iu kalua barra e provës.

27.5 Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me këtë rezultat edhe në seancën dëgjimore. Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultatit të hetimit, duke mbetur në kushtet e pamjaftueshmërisë së të ardhurave për vitin 2005, por duke qenë se kjo shumë është e ulët, nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni në vendimmarrjen përfundimtare për rivlerësimin e kriterit pasuror të subjektit.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

28. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, por nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting*, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

28.1 Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burimi për blerjen e apartamentit ka qenë huaja në shumën 30.000 euro e marrë nga motra e tij, znj. E. Gj..

28.2 Subjekti nuk provoi mundësitë financiare të huadhënësit në shumën 30.000 euro, duke e vënë atë në pozitën e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas germës “b” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

28.3 Subjekti nuk ka deklaruar qartësisht, dhe me dokumentacion mbështetës, marrëdhënien e pronësisë me apartamentin me sip. 63 m² në Fier, duke e vënë sërish në pozitën e deklaramit të pamjaftueshëm, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

28.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Albano Çepele, ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

29. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramiteve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

29.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar:

- a. raport²¹ me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Sipas këtij raporti, mosdeklaramiti nga subjekti i rivlerësimit i procedimit penal²² në ngarkim të tij e ngarkon subjektin me përgjegjësinë e fshehje së fakteve dhe të plotësimit të pasaktë dhe me vërtetësi të Deklaramit për Kontrollin e Figurës (neni 39/2). DSIK-ja vijon, më tej, duke

²¹ Deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 15.6.2020.

²² Procedim nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprën penale “shpërdorim detyre” parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal dhe për veprën penale “falsifikim i dokumentave”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

argumentuar se në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit apo pastërtisë së figurës së një funksionari publik, në cilësinë e gjyqtarit, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerjen ose moskryerjen e veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për vetë si funksionar publik apo personave të tjerë të lidhur me të duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo personave të tjerë çënojnë figurën e tij, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t'u vënë në presion nga strukturat kriminale sipas përcaktimeve të germës "c", të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.

Si konkluzion DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Albano Çepele.

- b. Në datën 4.6.2020, DSIK-ja ka dërguar me shkresë nr. ***, raportin²³ e përditësuar në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

Sipas këtij raporti rezulton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive nga viti 2014 – 2020.
- ii. "... mbi situatën e tjetërsimit të pronave publike nëpërmjet dokumentave të fallsifikuar në një fshat të Bashkisë Shkodër", një sipërfaqe toke është përvetësuar me vendim gjykate nga disa persona në mënyrë abuzive, nëpërmjet fallsifikimit të dokumentacionit. Një ndër gjyqtarët e përmendur në këtë çështje është edhe Albano Çepele.
- iii. Gjithashtu, Albano Çepele, evidentohet edhe në informacionin ... ku përmendet në rolin e gjykatësit të një çështje, që raportohet se një nga palët e interesuara në bashkëpunim ka fallsifikuar dokumentet e pronësisë duke mundësuar tjetërsimin e pronës publike.

29.2 DSIK-ja, vijon duke argumentuar se:

- i. Të dhënat që disponohen për subjektin vlerësohen për aktualitetin e tyre, kohëzgjatjen, pra më shumë se një herë, të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundraligjshme, në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së tij funksionale.
- ii. Duhet vlerësuar fakti që për subjektin e rivlerësimit autoritetet verifikuese kanë informuar instancat përkatëse, për trajtimin dhe shqyrtimin e rasteve të dyshuara të abuzimit me detyrën apo përfshirjen në marrëdhënie korruptive të funksionarëve të sistemit të drejtësisë.
- iii. Bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të paparshatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjekteve me krimin e organizuar, me së pari subjekti i rivlerësimit është vetë subjekti i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.

²³ Deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 15. 6.2020.

- iv. Mbi bazën e informacioneve që disponohen për subjektin në cilësinë e gjyqtarit për raste të mundshme të premtimit apo kërkimit drejtëpërdrejt apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën e tij funksionale gjatë fazës së gjykimit të një çështje penale, marrëdhënie korruptive e vendosur mes tij dhe palës tjetër që mund të jetë personi në gjykim apo një person tjetër i lidhur është një marrëdhënie apo kontakt i papërshtatshëm në papajtueshmëri të plotë me detyrën e tij funksionale.
- v. Marrëdhënia e dyshuar korruptive ndërmjetësohet dhe shtrihet në persona të tretë (palë në gjykim), lidhje pune të subjektit të rivlerësimit, duke vendosur sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, një kontakt të papërshtatshëm në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës nga subjekti.

29.3 Në përfundim DSIK-ja gjykon se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit në bashkëpunim cënon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ku subjekti vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale. Në këtë përfundim DSIK-ja mbështetet dhe në faktin se informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese janë marrë nga burime të besueshme.

Si konkluzion DSIK-ja ka konstatuar sërish papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Albano Çepele.

29.4 Nisur nga informacioni i ardhur nga autoritet verifikuese, trupi gjykues, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi provat e administruara nga ana e autoriteteve verifikuese. Në përfundim të këtyre hetimeve rezultoi se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështet informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese.

29.5 Në përfundim të hetimit i janë kërkuar shpjegime subjektit, sipas rezultateve, si vijon:

- Mosdeklarimi i procedimit penal të vitit 2015 “për shpërdorim detyre²⁴” dhe “falsifikim dokumentash²⁵”.
- Subjekti i rivlerësimit dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive nga viti 2014 – 2020.
- Subjekti, në rolin e gjyqtarit, dyshohet se është përfshirë në përvetësimin në mënyrë abuzive nga disa persona të një sipërfaqe toke me vendim gjykate, nëpërmjet fallsifikimit të dokumentacionit.
- Subjekti evidentohet të përmendet në rolin e gjyqtarit të një çështje që raportohet se një nga palët e interesuara në bashkëpunim ka fallsifikuar dokumentet e pronësisë duke mundësuar tjetërsimin e pronës publike.

29.6 Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim pas kalimit të barrës së provës. Ndërkohë në seancë, përfaqësuesi i subjektit, ka parashtruar se: “... nuk provohet domethënë në asnjë rast që ka pasur kontakte me persona apo që është përfshirë në veprimtari korruptive nga viti 2014 deri në vitin 2020. Albano Çepele, në gjithë vendimarrjen e tij, është i vetmi person që shoqërohet nga një person, shkon në gjykatë dhe kthehet në banesën e tij, vetëm i shoqëruar nga një person. Bisedat apo përgjigjet që mund të kenë rezultuar nga i gjithë ky proces nuk e inkriminojmë dhe

²⁴ Neni 248 i Kodit Penal.

²⁵ Neni 186/3 i Kodit Penal.

as nuk e përfshijnë gjyqtarin Albano Çepele në ndonjë veprimtari në të cilën të ketë ndikuar për të dhënë një vendim të padrejtë me koshiencën apo dijeninë e tij. As nuk provohen, as nuk relatohen as nuk ka indicie për sa i takon përfitimeve korruptive që mund të jenë të natyrave të ndryshme..... Dokumentacioni paraqitur përpara gjyqtarit ka qenë i fallsifikuar dhe normalisht palët në proces nuk kanë pasur kontestime për sa i takon vlerës dhe provueshmërisë së dokumentacionit në kuadër të hetimit të gjithanshëm, nuk rezulton asnjë veprim i gjyqtarit Albano Çepele që të cenojë vërtetësinë e dokumentacionit, pasi nuk ka asnjë konkluzion që hetimi nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm..... Për sa i takon tokës, që është përvetësuar, nuk ka, as nuk është relatuar një proces rishikimi i këtij vendimi mbi bazën e dënimit të personave apo sigurimit të dokumentacionit të falsifikuar.”

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

30. Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet që gjithnjë duhet të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

30.1 Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar procedimin penal të nisur ndaj tij me nr. ***, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale “shpërdorim detyre” parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal dhe për veprën penale “fallsifikim i dokumentave” parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal. Bazuar në nenin 34 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni konstaton se veprat penale të parashikuara në nenet 248 dhe 186/3 të Kodit Penal nuk përfshihen në veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Komisioni konkludon se subjekti ka qenë i saktë në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës.

30.2 Në lidhje me konstatimin e DSIK-së për përfshirje të subjektit në veprime korruptive, Komisioni vlerëson se nga studimi i materialeve të dosjeve të administruara²⁶ konstatohen shkelje të shumta profesionale, të cilat mund të lindin, por nuk provojnë dyshimet për korrupsion.

30.3 Komisioni vlerëson se nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo të jetë vetë i përfshirë.

30.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Albano Çepele ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

31. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGj-ja; kriteret e vlerësimit të

²⁶ Shihni vlerësimin profesional më poshtë.

parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe në denoncimet e paraqitura në Komision.

31.1 KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport nr. *** prot., datë 19.6.2020, të hollësishëm dhe të arsyetuar. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

31.2 Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit:

- i. Saktësia e formularit të vetëdeklarimit: formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi e kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji.
- ii. Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit: duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit, nga periudha janar 2006 – prill 2014, ka qenë në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në dhjetor të vitit 2016 është rikthyer në detyrë dhe aktualisht vijon detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- iii. Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore: subjekti i rivlerësimit në 3 vitet e fundit ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke punuar në seksionin civil dhe administrativo-penal. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka plotësuar rubrikën lidhur me specializime në fushën e së drejtës.
- iv. Trajnimet në 3 vitet e fundit: subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk ka marrë pjesë në trajnime në Shkollën e Magjistraturës, pasi në periudhën prill 2014 – 30.11.2016 ka qenë pa punë. Ka rifilluar punë në datën 1.12.2016 si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në zbatim të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti deklaroi se nuk ka pasur të tilla pasi ka qenë pa punë.

31.3 Tri dokumentet ligjore të paraqitura dhe të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, z. Albano Çepele, janë të llojit vendim gjyqësor. Vendimet e paraqitura i përkasin vitit 2013. Dy nga tri vendimet e paraqitura janë jashtë periudhës së rivlerësimit, pasi janë para datës 8.10.2013.

31.3.1 Dokumenti 1: vendimi nr. *** (***), datë 27.3.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me paditëse A. P., i paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shkodër, me objekt “pasaktësi e pjesshme e regjistrimit themeltar të vjetërsisë në punë të kooperativës bujqësore Mjede, fshati Shelqet duke saktësuar T. F. P. në A. P.. Njohjen e vjetërsisë në punë për periudhën 28.4.1969 – 15.2.1974, duke realizuar mesataren e ditëve të punës etj.”. Ky vendim është jashtë periudhës së rivlerësimit, pra, para datës 8.10.2013.

31.3.1.1 Nga analiza e kryer nga KLGj-ja ka rezultuar se çështja është regjistruar për gjykim në datën 19.3.2013 dhe vendimi është dhënë në datën 27.3.2013. Gjykimi ka zgjatur 12 ditë.

Ky afat është brenda afatit standard 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Nga pikëpamja formale, vendimi përmban 5 faqe. Ai paraqitet me strukturë të qartë, i ndarë në pjesë dhe me paragrafë të filluar me kryeradhë dhe veçuar me hapësirë dhe me 3 ndarje me kryeradhë të shkruar me shkrim *bold*. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.

31.3.1.2 Komisioni, ndryshe nga sa ka konkluduar KLGj-ja, konstaton se vendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i arsyetuar. Subjekti në vendim ka renditur provat e administruara, legjislacionin e zbatueshëm, si dhe konkluzionet e gjykatës. Vendimit i mungon arsyetimi, pasi nuk konstatohen argumentet e gjykatës që e çuan atë për të marrë vendim për pranimin e padisë. Në vendim nuk rezulton se cilat kanë qenë pretendimet e palës së paditur, si dhe nuk ka një analizë të fakteve dhe provave dhe të kuadrit ligjor në të cilën është mbështetur gjykata në marrjen e vendimit.

Komisioni, bazuar në analizën e mësipërme, vlerëson se vendimi nr. *** (***), datë 27.3.2013 nuk është i arsyetuar. Megjithëse subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij rezultati, ai nuk ka depozituar asnjë shpjegim ose dokument, duke mos e rrëzuar barrën e provës.

31.3.1.3 Në përfundim, Komisioni vlerëson se vendimi nr. *** është i paarsyetuar nga subjekti, duke treguar njohuri dhe aftësi të cekëta të tij, gjykim të dobët, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar.

31.3.2 Dokumenti 2: vendimi nr. *** (***), datë 18.12.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me paditëse T. Q., i paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shkodër, me objekt “konstatimin e pasaktësisë së pjesshme të fletës nr. ***, të regjistrit themeltar nr. ***, të ish-kooperativës bujqësore Velipojë, sektori Velipojë për sa i përket gjeneraliteteve nga F. N. Q. në T. N. Q.. Njohjen e vërtetësisë së shënimeve të fletës nr. ***, faqe ***, të ish-kooperativës bujqësore Velipojë në favor T. Q.”.

Çështja është regjistruar për gjykim në datën 12.9.2013 dhe vendimi është dhënë në datën 18.12.2013. Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 6 ditë. Ky afat është brenda afatit standard 6-mujor, të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. ***, datë 20.11.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil. Nga pikëpamja formale, vendimi përmban 3 faqe. Ai paraqitet me strukturë të qartë, i ndarë në pjesë dhe me paragrafë filluar me kryeradhë. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.

31.3.3 Dokumenti 3: vendimi nr. *** (***), datë 7.5.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me paditës M. U., i paditur E. F., A. F. me objekt “fitim pronësie me parashkrim fitues mbi një shtëpi banimi me nr. hipotekor ***, me sipërfaqe 52 m²”. Ky vendim është jashtë periudhës së rivlerësimit, para datës 8.10.2013.

Çështja është regjistruar për gjykim në datën 1.10.2012 dhe vendimi është dhënë në datën 7.5.2013. Gjykimi ka zgjatur 7 muaj e 6 ditë. Ky afat është jashtë afatit standard 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil.

Nga pikëpamja formale, vendimi përmban 3 faqe. Ai paraqitet me strukturë të qartë, i ndarë në pjesë dhe me paragrafë të veçuar me hapësirë. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.

31.4 Përshkrimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short:

31.4.1 Dosja 1 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 26.4.2012 regjistrimi, që i përket paditëse Xh. V. (D.), të paditur Bashkia Shkodër, Drejtoria Rajonale e Entit të Banesave Shkodër, me objekt “fitim pronësie mbi një pasuri të paluajtshme apartament banimi”, e përfunduar me vendimin nr. *** (***), datë 16.12.2013.

31.4.1.1 Komisioni, pasi analizoi dosjen gjyqësore, si dhe zhvilloi hetimin përkatës, konstatoi se:

- i. procesverbalet e seancave gjyqësore në periudhën 13.6.2012 – 27.11.2013 (gjithsej 18 seanca) rezultojnë se nuk janë firmosur nga sekretarja gjyqësore, detyrim i parashikuar nga neni 118 i Kodit të Procedurës Civile;
- ii. seancat gjyqësore të datave 14.11.2012; 19.12.2012; 15.1.2013; 17.9.2013; 11.11.2013 dhe 27.11.2013 janë shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit. Në proceverbal deklarohet se palët prezent morën dijëni;
- iii. nga verifikimi i listëprezencës së punonjësve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se subjekti ka qenë prezent në punë në datat e mësipërme;
- iv. nga verifikimi i procesverbalit të seancave gjyqësore të mësipërme nuk rezulton që ato të jenë firmosur nga ndonjë prej palëve për të vërtetuar faktin se kanë marrë dijëni;
- v. dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 8.1.2014, 22 ditë nga shpallja, në tejkallim të afatit të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile;
- vi. gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 1 vit 6 muaj e 20 ditë, në intervalin kohor 26.4.2012 – 16.12.2013. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

31.4.1.2 Për sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se:

- i. Subjekti e ka zbardhur vendimin në tejkallim të afatave të parashikuar nga legjislacioni procedural civil.
- ii. Subjekti e ka gjykuar këtë çështje jashtë afatit standard, duke cenuar të drejtën kushtetuese të palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

31.4.1.3 Subjekti, gjatë shqyrtimit gjyqësor, i ka kërkuar informacion me shkresën nr. *** regj. them., datë 2.4.2013, ZVRPP-së Shkodër në lidhje me gjendjen aktuale të pronës objekt gjykimi. Nga ZVRPP-ja Shkodër nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje për të sqaruar gjendjen aktuale të pronës, ndërkohë, nga pala paditëse është depozituar në cilësinë e provës fletë nga radhori me nr. ***. Në këtë fletë nuk pasqyrohet se në emër të kujt është regjistruar prona objekt gjykimi.

Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka marrë një vendim pa verifikuar legjitimitetin e palës së paditur Bashkia Shkodër, e cila gjatë gjithë procesit ka pretenduar se pasuria objekt gjykimi nuk është në pronësi të saj, si dhe nga subjekti nuk është verifikuar se në emër të kujt ka qenë i regjistruar apartamenti objekt gjykimi për të zgjidhur në këtë mënyrë drejt ndërgjyqësinë.

31.4.1.4 Megjithëse subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, nuk ka depozituar asnjë shpjegim ose dokument, duke mos e rrëzuar barrën e provës.

31.4.1.5 Në përfundim, Komisioni vlerëson se nga subjekti, në gjykimin e dosjes së mësipërme, janë kryer shkelje procedurale, nuk janë respektuar afatet standarde për gjykimin e çështjes, si dhe afatet procedurale për zbardhjen në kohë të vendimit, duke cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, subjekti ka marrë vendim pa pritur përgjigjen e ZVRPP-së Shkodër për të verifikuar legjitimitetin e palës së paditur Bashkia Shkodër.

Si rrjedhojë, subjekti, në gjykimin e kësaj dosjeje, ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta, gjykim të dobët, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar, si dhe ka cenuar të drejtat e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

31.4.2 Dosja 2 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 30.7.2012 regjistrimi, që i përket paditëses M. B. etj., të paditur Gj. B. etj., person i tretë ZVRPP-ja Malësi e Madhe, z. P. P. etj., me objekt “pavlefshmëri absolute e kontratave, detyrimin për njohje bashkëpronare dhe sigurim padie”, e përfunduar me vendimin nr. *** (***), datë 25.11.2013.

31.4.2.1 Komisioni, pasi analizoi dosjen gjyqësore, ka konstatuar se:

- i. Seancat gjyqësore të datave 24.12.2012; 24.6.2013 dhe 17.9.2013 janë shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit. Në proceverbal deklarohet se palët prezent morën dijëni.
- ii. Nga verifikimi i listëprezencës së punonjësve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se subjekti ka qenë prezent në punë në datat e mësipërme.
- iii. Nga verifikimi i procesverbalit të seancave gjyqësore të mësipërme nuk rezulton që të jenë firmosur nga ndonjë prej palëve për të vërtetuar faktin se ata kanë marrë dijëni.

31.4.2.2 Subjekti, në seancën gjyqësore të datës (seanca 5) 13.3.2013, bazuar në nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të vazhdojë gjykimin në mungesë të të paditurve dhe personave të tretë. Komisioni, pasi verifikoi procesverbalin e seancës së datës 13.3.2013, konstaton se i padituri, z. R. B., nuk ka marrë njoftim për zhvillimin e seancës, pasi ndodhet në Mal të Zi, ndërkohë që gjykata nuk shprehet në lidhje me njoftimin e të paditurit, z. Gj. B.. Nga aktet e njoftimit rezulton se ai nuk ka marrë dijëni për zhvillimin e seancës përgatitore.

Për sa më sipër, rezulton se subjekti nuk duhej të kishte vendosur vazhdimin e gjykimit në mungesë për sa kohë dy nga të paditurit nuk kishin dijëni për zhvillimin e gjykimit, duke cenuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt.

31.4.2.3 Në këtë seancë pala paditëse ka paraqitur kërkesë për sigurim padie duke pretenduar se nga ana e të paditurve po kryhen punime, si dhe zyra e regjistrimit po kryen transaksione duke i tjetërsuar pasuritë objekt gjykim. Subjekti, në datën 13.3.2013, pra në të po të njëjtën ditë, pa njoftuar palët e tjera, ka vendosur me vendim të datës 13.3.2013 pranimin e kërkesës së palës së të paditurit.

31.4.2.4 Komisioni, pasi analizoi vendimin për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, ka konstatuar se:

- i. Vendimi nuk është i arsyetuar.

- ii. Subjekti nuk ka cituar se në cilat prova është bazuar për të konkluduar se nga ana e të paditurve po kryhen punime në pasuri, si dhe nga ZVRPP-ja Malësi e Madhe po kryhen veprime duke u tjetërsuar këto pasuri.
- iii. Në vendim nuk argumentohet se pse çështja ka karakter të ngutshëm, ndërkohë që kishte 6 muaj që po shqyrtohej nga subjekti.

31.4.2.5 Në seancën gjyqësore (seanca 11) të datës 15.7.2013 subjekti ka vendosur të vazhdojë gjykimin në mungesë të të paditurve dhe personave të tretë. Komisioni, pasi analizoi procesverbalet e seancave, konstaton se subjekti për të tretën herë ka vendosur gjykimin në mungesë, ndërkohë që i padituri, z. Gj. B., nuk ka pasur dijeni për zhvillimin e gjykimit. Gjykata nuk mund të vendosë gjykimin në mungesë për çdo seancë. Gjithashtu, nga subjekti nuk është vendosur revokimi i vendimit për gjykimin në mungesë të z. R. B., i cili është paraqitur në këtë seancë.

31.4.2.6 Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 18.12.2013, 23 ditë nga shpallja, në tejkallim të afatit të parashikuar nga neni 308 Kodit të Procedurës Civile. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 1 vit, 3 muaj e 25 ditë, në intervalin kohor 30.7.2012 – 25.11.2013. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioni ka konkluduar se: (i) subjekti e ka zbardhur vendimin në tejkallim të afatave të parashikuar nga legjislacioni procedural civil; (ii) subjekti e ka gjykuar këtë çështje jashtë afatit standard, duke cenuar të drejtën kushtetuese të palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

31.4.2.7 Vendimi nr. *** (***), datë 25.11.2013, i subjektit të rivlerësimit nuk është i arsyetuar. Subjekti, në vendim, ka renditur pretendimet e palës paditëse dhe provat e administruara, ndërkohë nuk rezulton të jetë shprehur në lidhje me bazën ligjore, ku e mbështet vendimin e tij. Vendimit i mungon arsyetimi, pasi nuk konstatohen argumentet e gjykatës që e çuan atë për të marrë vendim për pranimin e padisë. Në vendim nuk ka një analizë të fakteve dhe provave, si dhe të kuadrit ligjor, në të cilën është mbështetur gjykata në marrjen e vendimit.

31.4.2.8 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të gjitha rezultatet e mësipërme. Subjekti nuk depozitoi as shpjegime dhe as prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

31.4.2.9 Në përfundim, Komisioni vlerëson se nga subjekti në gjykimin e dosjes së mësipërme janë kryer shkelje procedurale, nuk janë respektuar afatet standarde për gjykimin e çështjes dhe afatet procedurale për zbardhjen në kohë të vendimit, duke cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, vendimi për sigurimin e padisë dhe vendimi përfundimtar nuk janë të arsyetuar, si dhe subjekti ka vendosur vazhdimin e gjykimit në mungesë në një kohë që dy nga të paditurit nuk kishin dijeni për zhvillimin e gjykimit duke cenuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt. Si rrjedhojë, në gjykimin e kësaj dosjeje, subjekti ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta, gjykim të dobët, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar, si dhe ka cenuar të drejtat e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe për një proces të rregullt.

31.4.3 Dosja 3 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 12.9.2013 regjistrimi, që i përket paditës P. D., të paditur ZVRPP Shkodër, T. Z., Komuna Bushat me objekt “detyrimin për

njohje pronar mbi pasurinë tokë arë²⁷, regjistrimin e pasurisë”, e përfunduar me vendimin nr. *** (***), datë 23.12.2013.

31.4.3.1 Komisioni, pasi analizoi dosjen gjyqësore, konstatoi se:

- i. Padia nuk përmban elementët e kërkuar nga neni 153 i Kodit të Procedurës Civile, pasi për të paditurin mungojnë gjeneralitetet e plota (emri i babait). Subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kthyer padinë paditësit për të plotësuar të metat në zbatim të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile.
- ii. Subjekti ka vendosur gjykimin në mungesë të palës së paditur, por ndërkohë nuk ka pasur gjeneralitetet e plota me qëllim identifikimin e saktë të saj për të kryer njoftimin me shpallja. Nga ana e tij duhet të administroheshin të dhënat nga sistemi *TIMS* dhe t'i kërkohej palës paditëse gjeneralitetet e plota të palës së paditur.
- iii. Subjekti ka qenë në dijeni të faktit që z. Gj. P. (pronari i tokës objekt gjykimi) ka pasur trashëgimtare znj. T. Gj., pasi me vendim të tij nr. ***, të datës 24.9.2013 (i cili është marrë në të njëjtën ditë më zhvillimin e seancës së parë përgatitore të kësaj çështjeje) ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të z. Gj. P..

Për sa më sipër rezulton se subjekti ka zhvilluar gjykimin pa njoftuar palën e paditur, duke i cenuar të drejtën për një proces të rregullt.

31.4.3.2 Nga provat e dorëzuara nga pala paditëse nuk vërtetohet se si është fituar pronësia e tokës objekt gjykimi nga pala e paditur, si dhe faktin se cila është arsyeja që znj. T. Z. thirret si e paditur. Në lidhje me këtë konstatim Komisioni vlerëson se: (i) subjekti duhet të kishte kërkuar depozitim të dokumentacionit të rifreskuar të pasurisë objekt gjykimi, si dhe të kishte kërkuar prova në lidhje me gjeneralitetet dhe përfshirjen e znj. T. Z. si palë në proces; (ii) subjekti duhet të kishte administruar dëshminë e trashëgimisë që legjitimonte palën e paditur për të qenë palë në proces.

31.4.3.3 Në datën 4.10.2007, me vendimin nr. ***, Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 20.12.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këtë vendim është vendosur pranimi i padisë së z. Gj. P. me të paditur z. P. D. duke detyruar këtë të fundit t'i kthejë z. Gj. P. sipërfaqen prej 422 m². Pra, në një kohë kur trashëgimlënësit Gj. P. i është kthyer sendi, toka me sipërfaqe 422 m², me vendimin nr. ***, datë 20.12.2005, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 4.10.2007, Gjykatës së Lartë, rezulton se shtetasi P. Z. D., më 12.9.2013 ka ngritur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “detyrimin e palës së paditur T. Z. për të më njohur pronar mbi pasurinë e paluajtshme tokë arë” pretendim ky që tashmë ishte gjykuar, duke ezauruar të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Për sa më sipër rezulton se jemi përpara gjësë së gjykuar, pasi kemi të bëjmë më të njëjtën objekt padie, me të njëjtën pronë (objekt material), me të njëjtat palë. Për sa kohë një çështje i përket gjësë së gjykuar, asnjëra nga palët nuk ka më të drejtë për të ngritur të njëjtën padi. Si rezultat, subjekti, duke gjykuar këtë padi, ka cenuar parimet e “gjësë së gjykuar” dhe të drejtën e palës së paditur për një proces të rregullt.

31.4.3.4 Procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 24.9.2013, 21.10.2013, 5.11.2013 dhe 12.11.2013 rezultojnë se nuk janë firmosur nga sekretarja gjyqësore, detyrim i parashikuar nga

²⁷ Në pronësi të z. G. P..

neni 118 i Kodit të Procedurës Civile. Seanca gjyqësore e datës 21.10.201 është shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit. Në proceverbal deklarohet se palët prezent morën djeni. Komisioni konstaton se: (i) nga verifikimi i listëprezencës së punonjësve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se subjekti ka qenë prezent në punë në datën e mësipërme; (ii) nga verifikimi i procesverbalit të seancës gjyqësore të mësipërme nuk rezulton që të jenë firmosur nga ndonjë prej palëve për të vërtetuar faktin se ato kanë marrë djeni.

31.4.3.5 Subjekti ka vendosur detyrimin e komunës Bushat të njohë si pronar paditësin P. D., ndërkohë që objekti i padisë është detyrimi i palës së paditur T. Z. për të njohur si pronar paditësin P. D..

Subjekti, me cilësinë e gjyqtarit, ka vendosur për një objekt që nuk ka qenë objekt i kërkesëpadisë së palës paditëse, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6²⁸ të Kodit të Procedurës Civile.

31.4.3.6 Megjithëse subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, konstatohet se ai nuk ka depozituar asnjë shpjegim apo provë. Në përfundim, Komisioni vlerëson se në gjykimin e dosjes së mësipërme: nga subjekti janë kryer shkelje procedurale duke u cenuar parimi i gjësë së gjykuar, e drejta për një proces të rregullt pasi nuk është njoftuar pala, është pranuar gjykimi i një padie me të meta; subjekti nuk ka administruar të gjitha provat e nevojshme për gjykimin e çështjes. Si rrjedhojë, subjekti, në gjykimin e kësaj dosjeje ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta, gjykim të dobët, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar, si dhe ka cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.

31.4.4 Dosja 4 – çështja civile nr. *** regjistri themeltar, datë 10.2.2014 regjistrimi, që i përket kërkuese S. D., me objekt “korrigjim në vendimin me nr. ***, datë 20.9.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, e përfunduar me vendimin nr. *** (***), datë 14.2.2014.

Me këtë dosje nuk u konstatuan probleme.

31.4.5 Dosja 5 – çështja penale (masë sigurimi) nr. *** (***), datë 1.4.2014, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi ndaj të dyshuarit K. K. për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor dhe drejtimi i mjetit pa dëshmi aftësie, parashikuar nga nenet 290/2 dhe 291 të Kodit Penal”, e përfunduar me vendimin nr. *** (***), datë 2.4.2014.

Me këtë dosje nuk u konstatuan probleme.

31.5 Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

31.5.1 Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se subjekti ka marrë titullin Jurist nga Universiteti i Tiranës në datën 24.6.1997. Pas studimeve, më 24.1.1998, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, detyrë të cilën e ka kryer deri më 11.10.2003, kur është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Subjekti është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit me vendimin nr. ***, datë 15.4.2014, të KLD-së dhe me vendimin nr. ***, datë 11.4.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është rikthyer në detyrë.

²⁸ Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

31.5.2 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin janë paraqitur gjithsej 4 ankesa (1 në vitin 2013, 2 në vitin 2014, 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së.

- 2 ankesa (1 në vitin 2013, 1 në vitin 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se nuk ka fakte dhe rrethana të vlefshme për verifikim;
- 2 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë: 1 ankesë e vitit 2014, e cila është informacion periodik nga kryetari i gjykatës është verifikuar për mosdorëzim në afat të vendimeve gjyqësore dhe është vendosur tërheqje vëmendjeje me shkrim, si dhe evidentim për efekt vlerësimi etik e profesional; 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit është arkivuar pasi pretendimet janë të pabazuara.

31.5.3 Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit, ministri i Drejtësisë ka depozituar një kërkesë me nr. *** prot., datë 9.1.2014 (protokolluar pranë ish-KLD-së me nr. *** prot., datë 10.1.2014), për procedim disiplinor, duke propozuar masën “shkarkim nga detyra”. Kërkesa është shqyrtuar fillimisht në mbledhjen e ish-KLD-së, datë 24.2.2014, e cila është shtyrë. Më pas është shqyrtuar në mbledhjen e datës 15.4.2014, ku me vendimin nr. ***, datë 15.4.2014, gjyqtari ka marrë masën e propozuar në kërkesë “shkarkim nga detyra”. Vendimi i ish-Këshillit është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur “prishje e vendimit dhe kthimi i çështjes për rigjykim”, me vendimin nr. ***, datë 13.10.2014. Kërkesa është rifutur për shqyrtim në mbledhjen e datës 22.12.2015, ku sërish ish-Këshilli ka pranuar propozimin për dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” me vendimin nr. ***, datë 22.12.2015. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 11.4.2016, kanë vendosur “shfuqizim vendim nr. ***, datë 22.12.2015, të ish-KLD-së”.

31.6 Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 16.1.2020, i ka kërkuar informacion Ministrisë së Drejtësisë dhe KLGj-së në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

31.6.1 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2020, të Ministrisë së Drejtësisë për subjektin e rivlerësimit rezulton se:

31.6.1.1 Nga KLD-ja në më shumë së një rast janë hartuar raporte, ku vihet në dukje zbardhja me vonesë e vendimeve nga subjekti.

- a. Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 20.3.2013, të KLD-së rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar vendime në tejkalim²⁹ të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, të cilat do të trajtohen më poshtë. Në tabelën më poshtë janë pasqyruar ato vendime, të cilat nuk janë përfshirë në listën e vendimeve të zbardhura me vonesë në shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nr.	Nr. vendimi	Objekti	Palët	Data e dorëzimit	Tejkalim i afatit
1.	Nr. ***, datë 10.7.2012	Vërtetim Fakti Juridik	D. M. DRSSH Shkodër	5.9.2012	1 muaj e 25 ditë

²⁹ Në lidhje me këto vonesa, subjekti ka deklaruar se vonesat për vendimet e muajit korrik kanë ardhur si pasojë e pushimeve të muajit gusht, ndërsa për të tjerat vonesat kanë ardhur si pasojë e ngarkesës në punë.

2.	Nr. ***, datë 13.6.2012	Vërtetim Fakti Juridik	T. U. DRSSH Shkodër	5.9.2012	2 muaj e 22 ditë
3.	Nr. ***, datë 18.7.2012	Vërtetim Fakti Juridik	Z. L. DRSSH Shkodër	5.9.2012	1 muaj e 17 ditë
4.	Nr. ***, datë 16.7.2012	Vërtetim Fakti Juridik	D. G. DRSSH Shkodër	5.9.2012	1 muaj e 19 ditë
5.	Nr. ***, datë 14.6.2012	Lëshim Urdhri Ekzekutimi	ProCredit	10.9.2012	2 muaj e 26 ditë
6.	Nr. ***, datë 10.9.2012	Lëshim Urdhri Ekzekutimi	M. P.	20.9.2012	10 ditë
7.	Nr. ***, datë 12.9.2012	Masë Sigurimi	Prokuria Shkodër	24.9.2012	21 ditë
8.	Nr. ***, datë 12.9.2012	Lëshim dëshmi trashigimie	M. H.	27.9.2012	15 ditë
9.	Nr. ***, datë 10.7.2012	Pagesë vjetërsie	A. Sh. Cez sh.a.	11.10.2012	3 muaj e 1 ditë
10.	Nr. ***, datë 16.7.2012	Anulim Akti Administrativ	A. D. Zona e Shpërndarjes Elektrike, Dega Shkodër	11.10.2012	2 muaj e 25 ditë
11.	Nr. ***, datë 18.7.2012	Kthim shume	M. M. Komuna Bushat	11.10.2012	2 muaj e 23 ditë
12.	Nr. ***, datë 18.9.2012	Lëshimi i Dëshmisë së Trashigimisë	V. S.	2.10.2012	14 ditë

- b. Bazuar në relatimin e inspektorëve të ILKLD-së, datë 18.3.2014, mbi verifikimin e informacionit periodik të kryetarëve të gjykatave, për mosdorëzimin në afat të vendimeve gjyqësore rezulton se subjekti ka dorëzuar vendime në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, të cilat do të trajtohen më poshtë. Në tabelën më poshtë janë pasqyruar ato vendime, të cilat nuk janë përfshirë në listën e vendimeve të zbardhura me vonesë në shkresën nr. 478 prot., datë 19.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Nr.	Nr. vendimi	Objekti	Palët	Data e dorëzimit	Tejkalim i afatit sipas KPK ³⁰
1.	Nr. ***, datë 21.5.2013	Rivendosje në afat	Z. D.	12.7.2013	22
2.	Nr. ***, datë 10.6.2013	Rivendosje në afat	R. U.	12.7.2013	1 muaj e dy ditë
3.	Nr. ***, datë 25.6.2013	Deklarimi i palvefshmerisë së pjesshme të librezës së punës	B. C., DRSSH Shkodër	30.7.2013	1 muaj e 5 ditë

³⁰ Komisioni, ndryshe nga sa kanë konstatuar inspektorët e ILKLD-së në lidhje me vonesat në zbardhjen e vendimeve, vlerëson se afatet e këtyre vonesave janë më të lartë pasi afati 10-ditor, bazuar në nenin 308 zbatohet vetëm në çështje të ndërlikuara. Për sa kohë vendimet që kanë pasur vonesa nuk përfshihen te çështjet e ndërlikuara dhe afatit sipas llogaritjes së ILKD-së i janë shtuar edhe 10 ditë, fakt i cili është pasqyruar në këtë kolonë.

- c. Nga Komisioni, përveç çështjeve të mësipërme, pas verifikimit të shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. *** prot., datë 28.10.2013 pjesë e dosjes së KLGj-së, janë konstatuar vendime të tjera të dorëzuara në tejkalim të afatave të parashikuara nga legjislacioni procedural civil, të cilat nuk janë përfshirë në listën e vendimeve të zbardhura me vonesë në shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

1.	Nr. ***, datë 25.6.2013	Civile	S. D.	9.7.2013	14 ditë
2.	Nr. ***, datë 25.6.2013	Civile	N. Ç.	12.7.2013	17 ditë
3.	Nr. ***, datë 18.6.2013	Civile	A. D.	12.7.2013	24 ditë
4.	Nr. ***, datë 15.7.2013	Civile	B. D.	30.7.2013	15 ditë
5.	Nr. *** datë 15.7.2013	Civile	E.K.B	30.7.2013	15 ditë
6.	Nr. *** datë 15.7.2013	Civile	B. D.	30.7.2013	15 ditë
7.	Nr. *** datë 9.7.2013	Civile	S. P.	30.7.2013	21 ditë

31.6.1.2 Komisioni, bazuar në të dhënat e mësipërme, e ka shtrirë hetimin e tij në lidhje me vendimet e dorëzuara në tejkalim të afateve, të parashikuara nga legjislacioni procedural civil. Për këtë qëllim i është kërkuar informacion i detajuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Bazuar në të dhënat e kësaj gjykate³¹ rezulton se subjekti, në mënyrë sistematike për periudhën 2006 – 2014, ka dorëzuar vendime në tejkalim të afateve të parashikuara nga legjislacioni procedural penal, si vijon:

Viti 2006

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2006, ka shpallur 376 vendime, nga të cilat 46 janë zbardhur në tejkalim të afateve. Gjatë këtij viti, ai nuk ka munguar asnjë ditë në punë bazuar në të dhënat e administruar nga gjykata.

Subjekti, në 16 raste, ka tejkaluar afatet në një distancë kohore të konsiderueshme nga 1 muaj e 4 ditë deri në 8 muaj e 7 ditë. Në të gjitha rastet (me përjashtim të një vendimi) vendimet janë zbardhur në tejkalim edhe të afateve të ankimit. Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatuar afatet e gjyqimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Viti 2007

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2007, ka shpallur 299 vendime, nga të cilat 53 janë zbardhur në tejkalim të afateve. Gjatë këtij viti, subjekti ka munguar 20 ditë (gjithë muajin prill) për shkak shëndetësor. Komisioni ka marrë në konsideratë këtë fakt, si dhe faktin se muaji gusht ka qenë pushim, por këto ditë mungese nuk kanë ndikuar në tejkalimin e afateve nga subjekti pasi edhe duke mos u përfshirë në afat, sërish vendimet janë zbardhur në tejkalim të afateve të ligjit procedural, por edhe të ankimit. Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar

³¹ Shihni kthim-përgjigjen nr. *** prot., datë 19.6.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Viti 2008

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2008, ka shpallur 378 vendime, nga të cilat 29 janë zbardhur në tejkalim të afateve. Gjatë këtij viti subjekti ka munguar 12 ditë (3 dite pa arsye).

Në të gjitha rastet, vendimet janë zbardhur në tejkalim të afateve të ankimit.

Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Viti 2009

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2009, ka shpallur 415 vendime, nga të cilat 84 janë zbardhur në tejkalim të afateve. Gjatë këtij viti ai ka munguar 35 ditë, nga të cilat 9 ditë për shkak të sëmundjes së tij.

Subjekti, në 19 raste, ka tejkualuar afatet në një distancë kohore të konsiderueshme nga 1 muaj deri në 3 muaj e 11 ditë. Në të gjitha rastet (me përjashtim të një vendimi) vendimet janë zbardhur në tejkalim edhe të afateve të ankimit.

Komisioni ka marrë në konsideratë edhe faktin që subjekti ka munguar 19 ditë në muajin korrik për shkak të sëmundjes së tij, si dhe lejen e zakonshme (në total qershor – gusht, 1 muaj e 21 ditë të justikuara), por sërish këto mungesa nuk ndikojnë në zbardhjen e vendimeve në tejkalim të afatit, por thjesht ulin kohën e tejkalimit të afatit të zbardhjes së vendimit.

Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Viti 2010

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2010, ka shpallur 433 vendime, nga të cilat 38 janë zbardhur në tejkalim të afateve. Gjatë këtij viti subjekti ka munguar 11 ditë.

Në pjesën më të madhe të rasteve vendimet janë zbardhur në tejkalim të afateve të ankimit.

Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Viti 2011

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2011, ka shpallur 436 vendime, nga të cilat 115 janë zbardhur në tejkalim të afateve. Gjatë këtij viti ai ka munguar 38 ditë (3 ditë pa arsye), 15 ditë për shkak të sëmundjes së tij.

Komisioni ka marrë në konsideratë këtë fakt, si dhe mungesat për periudhën mars - qershor (32 ditë) dhe lejet e zakonshme, por këto ditë mungese nuk kanë ndikuar në tejkalimin e afateve nga subjekti.

Subjekti, në 42 raste, ka tejkualuar afatet në një distancë kohore të konsiderueshme nga 1 muaj deri në 2 muaj e 9 ditë. Në pjesën më të madhe, vendimet janë zbardhur në tejkalim të afateve të ankimit.

Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Në lidhje me urdhrat e ekzekutimit subjekti ka tejkualuar afatet në të gjitha rastet, duke cenuar të drejtën e palës për një proces të rregullt, duke penguar palën në ekzekutimin në kohë të vendimit.

Viti 2012

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2012, ka shpallur 625 vendime, nga të cilat 290 janë zbardhur në tejkualim të afateve. Gjatë këtij viti ai ka munguar 5 ditë (3 ditë pa arsye).

Subjekti, në 137 raste, ka tejkualuar afatet në një distancë kohore të konsiderueshme nga 1 muaj deri në 6 muaj e 1 ditë. Në pjesën më të madhe vendimet janë zbardhur në tejkualim edhe të afateve të ankimit.

Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Në lidhje me urdhrat e ekzekutimit subjekti ka tejkualuar afatet në të gjitha rastet, duke cenuar të drejtën e palës për një proces të rregullt, duke penguar palën në ekzekutimin në kohë të vendimit.

Viti 2013

Subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2013, ka shpallur 432 vendime, nga të cilat 199 janë zbardhur në tejkualim të afateve. Gjatë këtij viti ai ka munguar 25 ditë, nga të cilat 7 ditë për shkak të sëmundjes së tij. Komisioni ka marrë në konsideratë këtë fakt si dhe lejet e zakonshme, por këto ditë mungese nuk kanë ndikuar në tejkualimin e afateve nga subjekti, nga ku rezulton se edhe duke mos përfshirë në afat mungesat, sërish vendimet janë zbardhur në tejkualim të afatave ligjore.

Subjekti, në 38 raste, ka tejkualuar afatet në një distancë kohore të konsiderueshme nga 1 muaj deri në 3 muaj e 21 ditë. Në pjesën më të madhe vendimet janë zbardhur në tejkualim edhe të afateve të ankimit.

Vonesa në zbardhjen e vendimeve ka cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi ka zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit.

Në lidhje me urdhrat e ekzekutimit, subjekti ka tejkualuar afatet në të gjitha raste duke cenuar të drejtën e palës për një proces të rregullt, duke penguar palën në ekzekutimin në kohë të vendimit.

Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, por ai nuk ka depozituar asnjë shpjegim apo provë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nga subjekti në shumicën e rasteve, vonesat janë në tejkualim të afatit të ankimit. Këto vonesa kanë cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një e drejtë kushtetuese, pasi kanë zgjatur afatet e gjykimit në gjykatat më të larta, si dhe afatet e ekzekutimit të vendimit. Ndërkohë në rastin e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit moszbardhja e vendimit ka cenuar të drejtën e palëve për të vijuar me

ekzekutimin e vendimit si pjesë e së drejtës për një proces të rregullt, e cila në thelb, nuk mund dhe nuk duhet të konceptohet si një e drejtë, e cila qëndron vetëm te dhënia e vendimit, por edhe tek ekzekutimi i tij.

Si rrjedhojë, subjekti nuk është efektiv, ka treguar mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar, si dhe ka cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt.

31.6.1.3 Ankesat e depozituara në KLD

- Ankuesi S. J. ka parashtruar se subjekti nuk po gjykonte kërkesën e tij për sigurim padie.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti nuk ka respektuar afatin 5-ditor për shqyrtimin e kësaj kërkee. Në lidhje me këtë vonesë, subjekti, në shkresën dërguar ministrit të Drejtësisë, sqaron se vuan nga një sëmundje e pashërueshme *** dhe nga një sëmundje ***. Në periudhën e kësaj kërkesë, ai ka pasur humbje të ekuilibrit dhe shikimit duke u kuruar në spitalin *** me serum *** (*** në doza të mëdha). Ky trajtim nuk i lejonte të vazhdonte punën rregullisht.

Arsyet e paraqitura prej tij janë marrë në konsideratë nga Komisioni, i cili vlerëson se në një rast të tillë, subjekti, duke marrë në konsideratë natyrën emergjente të kërkesës duhej të jepte dorëheqje nga gjykimi i saj, duke shmangur në këtë mënyrë cenimin e së drejtës kushtetuese të kërkuarit për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova në lidhje me këtë vonesë, e cila ka ndikuar në zhvillimin e një procesi të rregullt pasi nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, por ai nuk depozitoi asnjë shpjegim apo provë për të kundërtën e vlerësimit të Komisionit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka qenë efektiv, duke cenuar të drejtën e palëve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

- Dy ankuesit, M. M. dhe E. Z., ankohen se marrja e masës së sigurimit të padisë nga subjekti është në shkelje flagrante me ligjin pasi vendimet e Entit Kombëtar të Banesave nuk mund të pezullohen, bazuar në nenin 3, të aktit normativ³² nr. ***, datë 1.8.2012, në të cilin thuhet se: *“Gjykata e Shkallës së Parë nuk mund të kryejë pezullimin e këtij urdhri ekzekutimi”*.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar:

- a. Çështja civile datë 2.9.2013 regjistrimi, me palë Pandi Strati etj. dhe person i tretë EKB me objekt “vendosja e masës së sigurimit në pronën... dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore”.

Në datën 23.8.2013 kërkuari Pandi Strati ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesë me objekt “kundërshtim akti administrativ..., kundërshtim i veprimeve përmbarimore, sigurim padie me palë të paditur: M. M., përmbaruesin G. B., AKKP-në Tiranë dhe person i tretë EKB-ja.

Në lidhje me këtë kërkesë, në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës..., dhe pezullimin e veprimeve përmbarimore.

Ky vendim rezulton të jetë ndryshuar nga Gjykata e Apelit, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës me vendimin nr. 86, datë 17.10.2013, duke argumentuar se Gjykata e Shkallës së Parë

³² Gjykata Kushtetuese ka shqyrtuar papajtueshmërinë e aktit normativ nr. *** dhe me vendim nr. ***, datë 6.2.2013 ka vendosur rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e aktit si të papajtueshëm me Kushtetutën.

ka vendosur në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 3 të ligjit nr. 82/2012, “Për miratimin e aktit normativ nr. ***, datë 1.3.2012”.

b. Çështja civile datë 2.7.2013 regjistrimi me palë T. Xh. me objekt “sigurim padie duke marrë masë provizore pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv...”.

Në lidhje me këtë kërkesë, në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës..., dhe pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv”.

Në këtë vendim, subjekti sqaron se Kodi i Procedurës Civile që është miratuar me shumicë të cilësuar prevalon para një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë.

Ky vendim rezulton të jetë ndryshuar nga Gjykata e Apelit, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës me vendim nr. ***, datë 26.9.2013.

Nga Komisioni, në lidhje me vendimet e mësipërme, rezulton se:

- i. në dispozitivin e vendimit gjyqësor me palë T. Xh. nga subjekti nuk është zbatuar detyrimi i përcaktuar në nenin 204/2 të Kodi i Procedurës Civile³³, pasi nga ana e tij në vendim nuk është përcaktuar afati 15-ditor për paraqitjen e padisë nga ana e kërkuarit. Afati duhej të caktohej nga gjykata pasi ai lidhet me shuarjen e masës së sigurimit të padisë sipas parashikimeve të nenit 211 të Kodi i Procedurës Civile³⁴;
- ii. në asnjë nga vendimet nuk argumentohet se cilat janë arsyet që e bëjnë gjykatën të dyshojë se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë, si dhe në cilat prova shkresore është mbështetur gjykata në dhënien e vendimit;
- iii. në çështjen gjyqësore me kërkuar T. Xh. nuk rezulton të jenë depozituar prova shkresore, përveç lajmërimit për ekzekutim vullnetar;
- iv. në vendimin e pezullimit me palë P. S. etj. rezulton se z. M. M. është pajisur me certifikatë pronësie më 9.4.2013. Ky fakt nuk është marrë në konsideratë nga gjykata;
- v. të dy vendimet janë në kundërshtim me parashikimet e nenit 3, të aktit normativ nr. ***, datë 1.8.2012, ku parashikohet se: “Gjykata e Shkallës së Parë nuk mund të kryejë pezullimin e këtij urdhri ekzekutivi”;
- vi. subjekti nuk ka njoftuar të paditurit M. M., AKKP Tiranë dhe përmbauesin G. B. për datën e seancës së shqyrtimit të kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë.

Subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova në lidhje me rezultatet e mësipërme, të cilat kanë ndikuar në të drejtat e palëve për të ushtuar të drejtën e tyre të pronësisë në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe për të drejtën kushtetuese të palëve për një gjykim të drejtë. Subjekti nuk paraqiti asnjë shpjegim apo provë për të kundërtën e këtij rezultati.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nga subjekti në gjykimin e dosjeve të mësipërme janë kryer shkelje procedurale, vendimet nuk janë të arsyetuar dhe janë marrë në kundërshtim me parashikimet e nenit 3, të aktit normativ nr. ***, datë 1.8.2012.

Si rrjedhojë, subjekti, në gjykimin e dosjeve të mësipërme ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta, gjykim të dobët, një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar, si dhe ka cenuar të drejtat e palëve për të ushtuar të drejtën e pronësisë, si dhe për gjykim të drejtë.

³³ Sigurimi i padisë mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë në gjykatën e vendit ku ka banimin paditësi ose ku ndodhet pasuria me të cilën do të sigurohet padia. Në këtë rast, gjykata cakton një afat jo më shumë se 15 ditë, brenda të cilit duhet të paraqitet padia në gjykatë.

³⁴ Mosparaqitja e padisë brenda afatit të caktuar nga gjykata, e vërtetuar nga kryesekretari, shuan masën e sigurimit të padisë.

31.6.2 KLGj-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2019, ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar, nga ku rezulton se:

1. KLD-ja, në mbledhjen plenare të datës 15.4.2014 me vendimin nr. ***, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” për subjektin.
2. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë 13.10.2014 kanë vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 15.4.2014, të KLD-së dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në KLD.
3. KLD-ja, me vendim nr. ***, datë 22.12.2015, ka vendosur marrjen e masës disiplinore për “shkarkim nga detyra” subjektin.
4. Me vendimin nr. ***, datë 4.4.2016, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur shfuqizimin e vendimit të KLD-së nr. ***, datë 22.12.2015.

31.6.2.1 Ankesat e administruara nëpërmjet KLGj-së

- Ankuesi B. D. pretendon për zvarritje të gjykimit dhe mosrespektim të normave të etikës.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se subjekti ka shtyrë seancën e datës 17.4.2012 me motivacionin për të njoftuar ZVRPP-në Shkodër dhe shoqërinë “****” sh.p.k dhe Bashkinë Shkodër. Kjo shtyrje nuk është në përputhje me nenin 175³⁵ të Kodit të Procedurës Civile, pasi palët kishin dijeni për seancën gjyqësore dhe nuk kishin paraqitur kërkesa për shtyrje seance, për rrjedhojë, subjekti, bazuar në nenin 179³⁶ të Kodit të Procedurës Civile duhej të kishte pyetur palën paditëse nëse kërkonte që gjykimi të vijonte në mungesë të palës së paditur dhe vetëm në rastin kur kjo palë do të shprehej se nuk pranonte që gjykimi të vijonte në mungesë të palës paditur, atëherë ai kishte të drejtë të shtynte seancën.

Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka shtyrë seancën gjyqësore në kundërshtim me nenin 175 të Kodit të Procedurës Civile. Për këtë iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, por subjekti nuk depozitoi asnjë shpjegim.

- Ankuesi J. Rr. ankohet se vendimi është dhënë nga sekretarja, duke përdorur dokumente të vjetra, korrupsion, duke e hequr truallit të shtëpisë.

Nga dokumentacioni i gjendur në dosjen e KLD-së, Komisioni konstaton se:

1. Vendimi gjyqësor³⁷ nr. ***, datë 10.5.2006 nuk është shpallur në orën e përcaktuar nga subjekti i rivlerësimit (09:00-9:30), por i është komunikuar palëve nga sekretarja gjyqësore pas pritjes për rreth dy orë.
2. Vendimi është shpallur në seancë nga subjekti në orën 14:10.
3. Subjekti, në datën 6.4.2006, i ka dhënë fund hetimit gjyqësor dhe ka shtyrë gjykimin për në datën 13.4.2006 për t’i dhënë mundësi palëve të depozitonin konkluzionet përfundimtare

³⁵ Pasi deklarohet çelja e seancës gjyqësore, gjykata verifikon paraqitjen e palëve dhe heton shkaqet kur njëra ose të dyja ato nuk janë paraqitur në seancë. Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak sëmundeje ose për ndonjë shkak tjetër të ligjshëm, gjykata shtyn gjykimin për një ditë tjetër.

³⁶ Nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit. Nëse i padituri nuk paraqitet në seancën e parë dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata cakton një seancë tjetër gjyqësore.

Nëse ky nuk paraqitet edhe në seancën tjetër gjyqësore dhe paditësi nuk kërkon që gjykimi të zhvillohet në mungesë, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

³⁷ Shihni deklarinimin e sekretares gjyqësore znj. M. B., datë 19.5.2008.

me shkrim. Subjekti ka caktuar seancën e radhës në tejkalim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 302³⁸ i Kodit të Procedurës Civile.

4. Në datën 13.4.2006, subjekti ka shtyrë sërish seancën gjyqësore për në datën 25.4.2006 për t'i dhënë mundësi palës së paditur dhe personave të tretë të paraqesin konkluzionet përfundimtare. Shtyrja e kësaj seance nga subjekti është në kundërshtim me dispozitat e nenit 302 të Kodi i Procedurës Civile.
5. Në datë 25.4.2006 subjekti ka shtyrë seancën gjyqësore për shpallje vendimi në datën 10.5.2006. Subjekti ka caktuar seancën e radhës në tejkalim të afateve ligjore të parashikuar nga nenin 308/2³⁹ i K.Pr.Civile.

Në analizë të sa më sipër ka rezultuar se:

- i. Subjekti ka zvarritur procesin gjyqësor, duke caktuar seancat gjyqësore në tejkalim të afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile.
- ii. Subjekti në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile i ka njoftuar paraprakisht palëve vendimin gjyqësor nëpërmjet sekretares gjyqësore për ta shpallur më pas në mungesë të palëve vendimin.
- iii. Subjekti nuk ka pasqyruar në vendim faktin që shpallja e vendimit është bërë në mungesë të palës paditëse dhe të paditur.

Megjithëse subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre rezultateve, ai nuk depozitoi asnjë provë apo shpjegim.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti në lidhje me këtë dosje ka treguar cilësi të papranueshme në punë, nuk është treguar efektiv, si dhe ka cenuar solemnitetin e gjykimit.

DENONCIMET

31.7 Në Komision janë paraqitur dy denoncime, por njëri prej tyre ankohej për vendimmarrje të padrejtë, gjë që është jashtë kompetencave të Komisionit për gjykim.

31.7.1 Denoncuesi D. P.⁴⁰ ka kërkuar nga Komisioni verifikimin e vendimeve:

1. Vendim nr. ***, lidhur me të cilin denoncuesi pretendon se pala e paditur K. M. Gj. nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

Këtë pretendimi ai e provon me shkresën nr. ***, datë 26.9.2012, lëshuar nga zyra e gjendjes civile Bashkia Shkodër.

2. Vendim gjyqësor nr. ***, datë 28.2.2012, sipas të cilit rezulton se z. D. P. ka paraqitur kërkesëpadi me palë të paditur Drejtorinë Rajonale të EKB-së Dega Shkodër.

Denoncuesi deklaron se nuk ka ngritur një padi të tillë dhe pretendon se ka ndryshim midis vendimit në procesverbalin e seancës dhe vendimit të zbardhur.

³⁸ Pasi të jenë shqyrtuar të gjitha provat që gjykata ka pranuar të merren, pyeten palët nëse kanë kërkesa të tjera në dobi të gjykimit të çështjes dhe, në rast se ato nuk pranohen, gjykata i jep fund hetimit gjyqësor dhe fton palët të parashtrajnë pretendimet përfundimtare të tyre rreth çështjes në gjykim. Si rregull, ato i parashtrihen gjykatës me shkrim. Me kërkesën e palëve, kur kjo shihet me vend, gjykata u jep atyre një afat deri në 5 ditë, për të përgatitur parashtrësit e tyre.

³⁹ Në çështje të ndërlikuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se 10 ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në 5 ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai ia beson këtë njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

⁴⁰ Nr. *** prot., datë 18.1.2018 dhe nr. ***, datë 30.6.2020.

3. Vendim gjyqësor nr. ***, datë 8.10.2012, ku denoncuesi pretendon se për dy garazhet të pretenduar se mbahen nga paditësi M. P., subjekti është shprehur me vendimin nr. ***, duke deklaruar se janë fituar nga z. D. P..

31.7.1.1 Nga Komisioni⁴¹ është kryer një hetim i plotë në lidhje me pretendimet e denoncuesit. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore civile që i përket vendimit nr. ***⁴², datë 28.2.2012, rezulton se:

- a. Në dosjen gjyqësore: mungojnë dokumentet që provojnë njoftimin e palëve për datat e seancave gjyqësore; dhe paditësi nuk ka firmosur në procesverbalin (i mosçeljes) e datës 8.2.2012 për marrjen dijeni të seancës së radhës.
- b. Në procesverbalin e seancës së datës 23.2.2012 deklarohet se pala paditëse ka depozituar provat e mëposhtme:
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***⁴³, lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër;
 - certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***⁴⁴, lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër;
 - autorizim lëshuar nga Komuna Strehim;
 - vërtetim nr. ***, lëshuar nga Bashkia Shkodër.

Pala paditëse ka deklaruar se nuk ka prova të tjera për të paraqitur.

Të njëjtat prova janë cituar edhe në procesverbalin e seancës së datës 28.2.2012.

Nga verifikimi i dosjes gjyqësore gjendet edhe dokumenti, i cili nuk rezulton të jetë depozituar nga asnjë nga palët në proces dhe nuk ka qenë objekt gjykimi:

- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ska që i përket pasurisë nr. ***.

Komisioni vlerëson se ka rezultuar se në dosjen gjyqësore, në kundërshtim me nenin 29⁴⁵ të Kodit të Procedurës Civile, gjenden dokumente që nuk janë depozituar nga palët dhe nuk janë administruar nga gjykata gjatë procesit gjyqësor.

- c. Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 28.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se kjo gjykatë në përfundim të gjykimit ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur për të njohur faktin juridik se paditësi D. M. P. ka fituar me parashkrim fitues pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme nr.*** dhe ***, ndodhur në z.k.***”*.

Ndërkohë në vendimin⁴⁶ e zbardhur, ndryshe nga sa është deklaruar në procesverbalin e seancës së datës 28.2.2012, rezulton që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër të ketë vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur për të njohur faktin juridik se paditësit D. M. P. i është dhënë autorizimi nga Këshilli Bashkiak mbi pasuritë e paluajtshme apartament kati i dytë ...”*.

Për sa më sipër, ka rezultuar se ka mospërputhje në dispozitivin e vendimit të gjykatës së pasqyruar në procesverbalin e seancës së datës 28.2.2012 dhe vendimit të zbardhur nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁴¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2020, kthim përgjigje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁴² Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 9.5.2012.

⁴³ I përket pasurisë nr. ***, z. k. ***, e llojit njësi.

⁴⁴ I përket pasurisë nr. ***, z. k. ***, e llojit njësi.

⁴⁵ Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore.

⁴⁶ Datë regjistrimi 23.1.2012.

d. Nga analizimi i vendimit të zbardhur nr. *** konstatohet se:

1. Në pjesën hyrëse, objekti i padisë është shënuar “fitimi i pronësisë me parashkrim fitues mbi pasurinë e paluajtshme ...”, ndërkohë në kërkesëpadi, në objektin e padisë nuk rezulton që paditësi të ketë kërkuar fitimin me parashkrim fitues të pasurisë apartament, pasi ai në padi deklaroi se është bërë pronar i dy garazheve. Ky fakt konfirmohet edhe nga procesverbali i seancave gjyqësore, ku në asnjë moment paditësi nuk ka pretenduar pronësinë mbi apartamentin.

Duket se gjykata në vendimin e zbardhur është shprehur për një pasuri që nuk ka qenë objekt i kërkesëpadi së palës paditëse, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6⁴⁷ të Kodit të Procedurës Civile.

2. Në pjesën përshkuese arsyetuese subjekti shprehet se: “Paditësi i është drejtuar gjykatës më padinë në gjykim përmes së cilës kërkon që të fitojë pronësinë me parashkrim fitues mbi pasurinë e paluajtshme ... këto janë pasuritë nr. ***... Paditësi pretendon me anë të provave shkresore që ky apartament banimi i ndodhur në katin e dytë i është dhënë me autorizim të këshillit bashkiak.”

Këto deklarime të subjektit nuk përputhen me kërkesëpadinë, ku paditësi deklaroi se:

*“Unë qysh në vitin 1994 me anë të një kontrate formale shitjeje jam bërë pronar i dy garazheve të ndodhur në lagjen ‘***’...Gjatë kësaj kohe unë jam sjellë sikur të isha pronar i tyre dhe këtë posedim e kam pasur të pandërprerë ...”.*

Gjithashtu, bazuar edhe në procesverbalet e seancave gjyqësore paditësi ka paraqitur prova shkresore për dy garazhet dhe jo apartament.

Për sa më sipër ka rezultuar se në zbardhjen e vendimit gjykata ka vendosur në bazë të provave, të cilat nuk janë administruar gjatë procesit gjyqësor dhe për një pasuri që nuk ka qenë objekt i kërkesëpadi së palës së paditur duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 309⁴⁸ të Kodit të Procedurës Civile.

31.7.1.2 Me vendimin nr. ***⁴⁹, datë 14.5.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur *detyrimin e të paditurit (K. M. Gj.) të kthejë sendet dhe lirojë pronat e EKB-së me nr. pasurie ..., nr. *** ... ***, z. k. ***.*

a. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore civile që i përket vendimit të mësipërm konstatohen mangësitë e mëposhtme:

- i. në dosje gjyqësore mungojnë dokumentet që provojnë njoftimin e palëve për datat e seancave gjyqësore;
- ii. mungojnë dokumentet për verifikimin e adresës së të paditurit K. M. Gj.;
- iii. mungojnë dokumentet që vërtetojnë njoftimin e z. K. M. Gj. në lidhje me datat e seancave gjyqësore;
- iv. mungojnë procesverbalet e seancave gjyqësore;
- v. mungon kërkesëpadi dhe provat e dorëzuara nga paditësi;
- vi. mungon dokumentacioni për të vërtetuar njoftimin e vendimit palës në mungesë.

⁴⁷ Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet.

⁴⁸ Vendimi mbështetet vetëm në të dhëna që ndodhen në aktet dhe që janë shqyrtuar në seancë gjyqësore. Gjykata çmon provat e marra gjatë gjykimin të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre.

⁴⁹ Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 6.7.2012.

b. Nga dokumentacioni i depozituar nga denoncuesi rezulton se bazuar në shkresën nr. ***, datë 26.9.2012, lëshuar nga zyra e gjendjes civile Bashkia Shkodër rezulton se shtetasi K. M. Gj. nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

31.7.1.3 Me vendimin⁵⁰ nr. ***, datë 8.10.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur *“detyrimin e palës së paditur për të njohur faktin juridik se paditësi M. P. ka fituar me parashkrim fitues pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme nr. ***, *** dhe *** ndodhur në z. k. ***”*.

a. Bazuar në procesverbalin e seancës së datës 1.10.2012 rezulton që paditësi të ketë depozituar provat e mëposhtme:

- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***⁵¹, lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***⁵², lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***⁵³, lëshuar nga ZVRPP-ja Shkodër.

b. Në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit subjekti shprehet:

“Paditësi M. P. pretendon me anë të provave shkresore që i ka poseduar në mënyrë të pandërprerë që ga viti 1997... Paditësi pretendon me anë të provave shkresore se ka qenë në mirëbesim dhe gjatë kësaj periudhe i ka poseduar qetësisht”.

Ky deklaram i subjektit nuk përputhet me deklaramin e paditësit në kërkesëpadi, i cili deklaron se *që nga viti 1994 me anë të një kontrate formale shitjeje është bërë pronar i disa pasurive...*

Bazuar në procesverbalin e seancës së datës 1.10.2012 nuk rezulton që paditësi të ketë depozituar prova shkresore për të vërtetuar posedimin e tij mbi pasuritë e paluajtshme objekt gjykimi.

Në analizë të tri vendimeve të mësipërme, Komisioni konstaton se subjekti në kundërshtim me nenin 451/a e Kodit të Procedurës Civile ka gjykuar tri çështje gjyqësore (secila prej tyre kishte marrë formë të prerë në momentin e gjykimit të tjetrës) për të njëjtin objekt padie duke dhënë tri vendime që nuk përputhen midis tyre⁵⁴.

Subjektit iu kalua barra e provës për të gjitha rezultatet e hetimit si më sipër, po ai nuk ka paraqitur asnjë provë apo shpjegim për të sqaruar pozicionin e tij si gjyqtar i çështjeve.

31.7.2 Në përfundim, në lidhje me tri dosjet e mësipërme, Komisioni vlerëson se nga subjekti janë kryer shkelje procedurale, në dy prej dosjeve konstatohen mangësi në dokumentacionin e tyre, subjekti në një prej dosjeve ka vendosur në bazë të provave, të cilat nuk janë administruar gjatë procesit gjyqësor dhe për një pasuri që nuk ka qenë objekt i kërkesëpadisë së palës së paditur, si dhe ka rezultuar se ka mospërputhje në dispozitivin e vendimit të gjykatës të pasqyruar në procesverbalin e seancës së datës 28.2.2012 dhe vendimit të zbardhur nr. ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Si rrjedhojë, subjekti në gjykimin e dosjeve të mësipërme ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta, gjykim të dobët si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si gjyqtar.

⁵⁰ Datë regjistrimit 24.9.2012.

⁵¹ I përket pasurisë nr. ***, z. k. ***, e llojit njësi.

⁵² I përket pasurisë nr. ***, z. k. ***, e llojit njësi.

⁵³ I përket pasurisë nr. ***, z. k. ***, e llojit njësi.

⁵⁴ *Fillimisht i ka njohur të drejtën e pronësisë D. P. me parashkrim fitues për pasuritë e paluajtshme garazhe, më pas detyron K. M. Gj. t'i kthejë garazhet EKB-së si pronar legjitimi dhe në fund detyron EKB-në për të njohur si pronar M. P. për këto garazhe, për të cilat në vendimin e datës 14.5.2012 kishte vendosur t'i ktheheshin EKB-së pasi ishte pronare e këtyre garazheve).*

Analiza e gjetjeve

31.8 Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga 5 grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLD; (iv) hetimit të Komisionit; dhe (v) denoncimeve të publikut.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si atij material e procedural civil. Në analizën e mësipërme është konstatuar se jo gjithmonë identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Gjithashtu, subjekti jo në të gjitha rastet e vëzhguara identifikon saktë marrëdhënien juridike, objekt shqyrtimi gjyqësor dhe, për rrjedhojë, nuk përcakton drejt ndërgjyqësinë e palëve në proces. Nga subjekti në asnjë prej vendimeve të analizuara nuk janë përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës dhe nuk ka aftësi për të analizuar jurisprudencën, si dhe nuk i referohet vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë apo vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në 4 raste subjekti ka cenuar parimin e gjësë së gjykuar.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar aftësi në drejtim të arsyetimit ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare, në shumicën e rasteve, janë të paarsyetuara. Në përmbajtjen e vendimit nuk evidentohet ndonjë analizë dhe dhënie përgjigjeje për të gjitha pretendimet e palëve në proces. Gjithashtu nuk ka një analizë të fakteve dhe provave, si dhe të kuadrit ligjor në të cilën është mbështetur gjykata në marrjen e vendimit. Në nxjerrjen e konkluzioneve, përgjithësisht, nuk i kushtohet rëndësi analizës së normës ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga Komisioni është konstatuar se subjekti në periudhën 2006 – 2014 ka zbardhur vendime në tejkalim të afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Në vitet 2012 dhe 2013 numri i vendimeve të zbardhura në tejkalim të afatave është gati sa gjysma e vendimeve të shqyrtuara nga subjekti. Nga Komisioni, në lidhje me këto vonesa, është bërë një hetim i plotë duke marrë në konsideratë edhe lejet vjetore të subjektit apo mungesat për shkak sëmundjeje, por ato nuk justifikojnë zbardhjen me vonesë të vendimeve nga subjekti pasi edhe nëse këto ditë hiqen nga afati i zbardhjes ato thjesht e ulin atë, por tejkalimi qëndron. Nga analizimi i të gjitha vendimeve afati më i gjatë është 8 muaj e 7 ditë.

Nga subjekti nuk janë respektuar dhe afatet e gjykimit, nga ku rezulton se në 2 raste periudha e gjykimit ka kaluar 1 vit e 3 muaj, duke tejkaluar me më shumë se dyfishin standardin e gjykimit.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit në disa raste nuk e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, si dhe në mënyrë të përsëritur edhe pas tërheqjes së vëmëndjes nga KLD-ja nuk ka respektuar kohën e arsyetimit (zbardhjes) së vendimeve gjyqësore. Mosrespektimi i afateve ka cenuar të drejtat kushtetuese të subjekteve për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe një procesi të rregullt.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti ka mangësi për të kryer procedurat gjyqësore pasi nga 44 seanca gjyqësore vëzhguar, vetëm 15 seanca kanë qenë produktive.

Subjekti ka shtyrë 7 seanca gjyqësore për arsye shëndetësore, ndërkohë nga verifikimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se ai ka qenë në punë. Nga subjekti, në disa raste, janë shkelur normat procedurale në lidhje me njoftimin e palëve në gjykim, vazhdimin e gjykimit në mungesë të palëve, verifikimin e identitetit të palëve, në një rast subjekti pavarësisht se padia nuk plotësonte elementët e kërkuar nga Kodi i Procedurës Civile nuk e ka kthyer atë, por ka vijuar gjykimin.

Në tri raste, çështjet e gjykuara prej tij janë kthyer për rigjykim për shkelje të procedurave gjyqësore, lidhur me vlefshmërinë e akteve procedurale të gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore nuk janë firmosur nga sekretarja gjyqësore, gjykimin në mungesë të pjesëmarrësve në proces, formimin e ndërgjyqësisë dhe konkretisht në legjitimitetin pasiv, si dhe nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm i çështjes.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga Komisioni janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dy raste, dosja nuk është e plotë pasi ka mungesë dokumentacioni. Janë vërejtur pasaktësi në procesverbalet e seancave gjyqësore pasi nuk janë firmosur nga sekretarja gjyqësore, shkak i cili në 1 rast ka çuar në prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se subjekti ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 24.6.1997. Pas studimeve, në datën 24.1.1998, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, detyrë të cilën e ka kryer deri më 11.10.2003, kur është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ai është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit me vendimin nr. ***, datë 15.4.2014, të KLD-së dhe me vendimin nr. ***, datë 11.4.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është rikthyer në detyrë, ku vazhdon dhe aktualisht.

b) Integriteti

Komisioni vlerëson se nga studimi i materialeve të dosjeve të administruara⁵⁵ konstatohen shkelje të shumta profesionale, të cilat mund të lindin, por nuk provojnë dyshimet në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Për subjektin në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe

⁵⁵ Shihni vlerësimin profesional më poshtë.

në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët, pasi çështjet janë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, si gjyqtar i vetëm në administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai deklaroi se nuk ka marrë pjesë në trajnime në Shkollën e Magjistraturës, pasi në periudhën prill 2014 – 30.11.2016 ka qenë pa punë. Ka rifilluar punë më 1.12.2016, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në zbatim të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti deklaroi se nuk ka pasur të tilla, pasi ka qenë pa punë. Në periudhën 2006 – 2014 nuk konstatohet që subjekti të ketë ndjekur program të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

31.9 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, për sa i takon kriterit profesional, pasi iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk depozitoi asnjë sqarim apo provë për të kundërtën. Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit deklaroi se: *“Për sa i takon kriterit profesional, Albano Çepele ka aftësi shëndetësore të kufizuara dhe gjithë sistemi mbështetës për sa i takon strukturave të gjykatave, lëvizjeve e transportit dhe e gjithë infrastruktura në Republikën e Shqipërisë nuk është e përshtatur për personat që kanë aftësi të kufizuara në lëvizje. Subjekti lëviz me zor, ka dokumentacion shëndetësor që e provon këtë dhe, në këto kushte, ka realizuar detyrën brenda mundësive që ka pasur si subjekt me aftësi të kufizuara për shkaqe shëndetësore.”*

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

32. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGj-ja dhe denoncimeve të depozituara në Komision, trupi gjykues konstaton gabime thelbësore dhe serioze, si dhe ekzistencën e një serie të qartë dhe të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjektit. Ai ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, vonesa dhe zvarritje të gjykimeve, që çojnë në cenim të të drejtave të palëve, si dhe nuk është efektiv.

33. Të gjitha këto të meta të konstatuara në vlerësimin profesional të subjektit vlerësohet se cenojnë besimin e publikut të një gjyqtar.

34. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

35. Komisioni konkludon se në vlerësimin e aftësive profesionale subjekti Albano Çepele është i papërshtatshëm, në kuptim të germës “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se:

- i. subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji;
- ii. subjekti rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale;
- iii. nga vlerësimi tërësor, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të këtij ligji rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Albano Çepele, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 20.11.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Genta TAFA (BUNGO)

Relatore

Etleda ÇIFTJA

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku

